

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA ELEZI KUNDËR SHQIPËRISË
(Kërkesa nr. 17141/21)

VENDIM
STRASBURG
23 qershor 2026

Ky vendim është i formës së prerë, por mund të jetë subjekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Elezi kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *Kryetare*,
Darian Pavli,
Mateja Đurović, *gjyqtarë*
dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit*,
Duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 17141/21) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar në Gjykatë, më 29 mars 2021, në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) nga një shtetas shqiptar, z. Ferdinand Elezi (kërkuesi), lindur në vitin 1968, me banim në Durrës, Shqipëri dhe i përfaqësuar nga z. T. Alexandridis, avokat i cili e ushtron profesionin në Kalamata, Greqi;

vendimin për të njoftuar mbi ankesën, në lidhje me shkarkimin e kërkuesit qeverinë shqiptare (qeveria) e përfaqësuar z. O Moçka, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, dhe për ta shpallur pjesën e mbetur të kërkesës të papranueshme;

vërejtjet e palëve;

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më 19 maj 2026,

Shpall vendimin e mëposhtëm, që u miratua në të njëjtën datë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me procedurat e rivlerësimit kalimtar (*vetting*-ut) të kërkuesit, të zhvilluara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA; shih, për një përshkrim të procesit të rivlerësimit, çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, 9 shkurt 2021).

2. Kërkuesi ka punuar si prokuror që nga viti 1999, së fundmi si kreu i prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës. Bashkëshortja e tij ka punuar si notere që nga viti 2000. Ata janë martuar në vitin 2004.

3. Pasuritë familjare të deklaruara në procedurat e rivlerësimit përfshinin: një apartament me sipërfaqe 124 m² në Tiranë, të blerë në vitin 2000 (me vlerë të deklaruar 40,000 dollarë amerikanë, të paguar përmes një kredie prej 4,000,000 lekësh (ALL), e cila ishte e disponueshme për zyrtarët e lartë shtetërorë, dhe një shume kursimesh); një zyrë me sipërfaqe 45 m² në Durrës, të blerë në vitin 2005 për 60,000 euro (EUR); dhe dy apartamente me sipërfaqe 185 m² në Durrës, njëri i blerë në vitin 2005 për 30,000 euro dhe tjetri i blerë në vitin 2007 për 4,000,000 lekë. Periudha e marrë në konsideratë për rivlerësimin ishte nga viti 2003 deri në vitin 2016.

4. Më 9 prill 2019, KPK-ja konstatoi se kërkuesi i kishte përmbushur kriteret e rivlerësimit për sa i përket kompetencës profesionale dhe pastërtisë së figurës, por nuk i kishte përmbushur ato për sa i përket vlerësimit të pasurisë dhe, për rrjedhojë, duhej të shkarkohej nga detyra. Në veçanti, kërkuesi nuk kishte arritur të justifikonte shpenzimet familjare dhe kursimet e deklaruara me burime të ligjshme, në shumën prej 3,044,938 lekësh, gjatë një periudhe shtatëvjeçare. Përveç kësaj mospërputhjeje, analiza financiare e KPK-së konstatoi teprica gjatë

shtatë viteve, në një shumë totale prej 3,565,581 lekësh, përfshirë 1,247,705 lekë për vitin 2004; 493,279 lekë për vitin 2006; 153,545 lekë për vitin 2009; dhe 734,308 lekë për vitin 2012.

5. Subjekti i rivlerësimit ankimoi, duke pretenduar se analiza financiare e KPK-së ishte e gabuar, pasi pagat e tij dhe e bashkëshortes, si dhe fitimet e bashkëshortes nga aktiviteti i saj si notere e vetëpunësuar, nuk ishin marrë plotësisht në konsideratë, ndërsa shpenzimet e tyre për jetesë dhe udhëtime ishin llogaritur gabimisht në vlera që tejkalonin ndjeshëm shpenzimet reale. Ai, gjithashtu, pretendoi se tepricat duhet të ishin mbartur për të kompensuar mospërputhjet e konstatuara në vitet pasuese.

6. Më 30 shtator 2020, KPA-ja, me tri vota pro dhe dy kundër, la në fuqi vendimin e KPK-së dhe shkarkoi subjektin nga detyra bazuar në vlerësimin e pasurisë së tij, në përputhje me nenin 61(3) të Ligjit për Rivlerësimin Kalimtar.

7. KPA-ja i pranoi pjesërisht pretendimet e subjektit. Analiza e saj financiare tregoi mangësi në shumën totale prej 1,084,253 lekësh gjatë katër viteve, konkretisht: 120,346 lekë në vitin 2005; 709,429 lekë në vitin 2007; 118,867 lekë në vitin 2008; dhe 135,611 lekë në vitin 2010. Tri vitet e tjera në shqyrtim treguan teprica në shumën totale prej 772,777 lekësh, konkretisht: 54,709 lekë për vitin 2013, 61,157 lekë për vitin 2014 dhe 656,911 lekë për vitin 2016.

8. Llogaritja e kostove të vlerësuara të jetesës u bazua në të dhënat e anketave të përgatitura nga Instituti i Statistikave. Për familjen e subjektit, kjo llogaritje përfshinte:

- 328,671 lekë për vitin 2005;
- 766,896 lekë për vitin 2007;
- 546,480 lekë për vitin 2008;
- 546,480 lekë për vitin 2010; dhe
- 564,096 lekë për vitin 2013.

Në llogaritjen e saj, KPA-ja nuk ofroi asnjë shpjegim, në lidhje me një rritje të kostove të jetesës së vlerësuara për vitin 2007.

9. Sa u përket kostove të kërkuarit për udhëtime jashtë vendit, KPA-ja e bazoi llogaritjen e saj në të dhënat nga policia, në lidhje me kalimet kufitare për periudhën nga viti 2008 deri në vitin 2016. Për periudhën nga viti 2004 deri në vitin 2007, KPA-ja u mbështet në llogaritjen e KPK-së, e cila ishte bërë në mungesë të të dhënave të tilla.

10. KPA-ja zbuloi se mospërputhjet konsistojnë në një mungesë burimesh të ligjshme për të llogaritur pasuritë dhe shpenzimet e kërkuarit në vitet përkatëse, gjë që justifikoi shkarkimin e tij. Sa i përket tepricave, KPA-ja vendosi se ato ishin kursime potenciale, jo reale, dhe, duke pasur parasysh faktin se kërkuari nuk i kishte regjistruar ato si kursime në deklaratat vjetore dhe në mungesë të provave dokumentare, ato nuk mund të merreshin parasysh për kompensimin e mospërputhjeve në vitet në vijim.

11. KPA-ja nuk konstatoi probleme, në lidhje me deklarimin e pasurive të paluajtshme të familjes ose fitimin e tyre nëpërmjet burimeve të ligjshme.

12. Në një mendim mospajtues, dy gjyqtarë deklaruan se mangësitë e identifikuar ishin të pamjaftueshme për të justifikuar shkarkimin e kërkuarit nga detyra, gjë që ishte disproporcionale në rrethana të caktuara. Shumat e vogla të mospërputhjeve për vitet 2005, 2008 dhe 2010 ishin të parëndësishme sipas një vlerësimi realist të aftësisë së një individi të verifikuar për të provuar ligjshmërinë e burimeve. Mospërputhjet lidheshin kryesisht me të ardhurat e ndryshueshme të gruas së tij si notere e vetëpunësuar dhe kostot e jetesës në familje, por jo me blerjen e ndonjë pasurie. Mospërputhja për vitin 2007 ishte ndikuar ndjeshëm nga një rritje e pazakontë dhe e paarsyeshme e standardit statutor për shpenzimet e jetesës së vlerësuara, mungesa e të dhënave të verifikueshme për vlerësimin e shpenzimeve për udhëtim dhe kompleksiteti i regjistrimit të të ardhurave nga aktivitetet noteriale të gruas së tij. Kërkuari duhej të konsiderohej se i kishte përmbushur kërkesat e verifikimit në vlerësimin e pasurive të tij dhe, duke pasur parasysh rezultatet pozitive të vlerësimit të tij për kriteret e integritetit dhe aftësive profesionale, duhej të konfirmohej në detyrë.

VLERËSIMI I GJYKATËS

SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 8 TË KONVENTËS

13. Kërkuesi u shkarkua nga posti i tij si prokuror karriere, duke humbur kështu funksionin e tij brenda sistemit të drejtësisë dhe shpërblimin financiar, me efekt të menjëhershëm. Kjo pati padyshim pasoja serioze për “rrethin e tij të ngushtë”, pra për mirëqenien e tij dhe atë të familjarëve të tij, si dhe ndikoi në jetën e tij private në një masë shumë të konsiderueshme. Për këtë arsye, neni 8 është i zbatueshëm (shih *Nikëhasani kundër Shqipërisë*, nr. 58997/18, § 86, 13 dhjetor 2022, me referenca të mëtejshme).

14. Gjykata vëren se ky pretendim nuk është haptazi i pabazuar sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës dhe as i papranueshëm për ndonjë shkak tjetër. Prandaj, ai duhet të shpallet i pranueshëm.

15. Gjykata konstaton se ka pasur një ndërhyrje në të drejtën e ankuesit për respektimin e jetës së tij private, e cila ishte në përputhje me ligjin dhe në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të tjerëve (shih *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, §§ 377-78, 384–88 dhe 391–93, 9 shkurt 2021).

16. Mbetet për t’u shqyrtuar nëse ndërhyrja ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, veçanërisht nëse ajo i përgjigjej një “nevoje urgjente shoqërore” dhe, në veçanti, nëse ishte proporcionale me qëllimet legjitime të ndjekura, dhe nëse arsyet e paraqitura nga autoritetet kombëtare për ta justifikuar atë ishin “relevante dhe të mjaftueshme”. Parimet e përgjithshme përkatëse janë përmbledhur në çështjet *Xhoxhaj* (të cituar më lart, §§ 402–03) dhe *Sevdari kundër Shqipërisë* (nr. 40662/19, §§ 83–86, 13 dhjetor 2022).

17. Gjykata tashmë ka arritur në përfundimin se reforma në sistemin e drejtësisë shqiptare, që përfshinte rivlerësimin (*vetting-un*) e jashtëzakonshëm të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, i përgjigjej një “nevoje urgjente shoqërore” (shih *Xhoxhaj*, të cituar më lart, § 404).

18. Shkarkimi i kërkuesit u bazua vetëm në vlerësimin e pasurisë së tij. Vlerësimi në lidhje me dy kriteret e tjera të rivlerësimit, përkatësisht pastërtinë e figurës dhe aftësinë profesionale, ishte pozitiv (shih paragrafin 4 më lart).

19. Nuk u konstatuan probleme nga KPA-ja, lidhur me burimin e ligjshëm apo deklarimin e pasurive të paluajtshme kryesore në pronësi të familjes së subjektit.

20. Problematika e vetme për të gjithë periudhën e vlerësimit kishte të bënte me katër vite, për të cilat analiza financiare e KAP-së tregoi një deficit të përgjithshëm prej 1,084,253 lekësh. Vlerat për tre nga këto vite, që varionin nga 118,867 lekë në 135,611 lekë, nuk ishin të konsiderueshme dhe përbënin vetëm 1.5% deri në 3.2% të të ardhurave totale të kombinuara familjare për secilin vit përkatës (shih paragrafët 7 dhe 8 më sipër).

21. Për vitin 2007 u konstatua një deficit më i madh, konkretisht 709,429 lekë, që përbënte 12.4% të të ardhurave totale të kombinuara familjare. Megjithatë, duket se llogaritja e tij duhej marrë me rezerva. Llogaritja tregoi një rritje prej 133% të kostove të vlerësuara të jetesës për familjen e subjektit në vitin 2007 krahasuar me vitin 2006. Shuma e kostove të vlerësuara të jetesës për vitin 2007 ishte më e lartë edhe në krahasim me vitet 2008, 2010 dhe 2013, të cilat përfshiheshin në periudhën gjashtëvjeçare pasuese (shih paragrafin 8 më sipër). Në mungesë të ndonjë shpjegimi nga KPA-ja në vendimin e saj, një rritje kaq e konsiderueshme nuk mund të konsiderohet bindëse. Së fundmi, llogaritja e kostove të përlllogaritura për udhëtime për vitin 2007 u krye në mungesë të të dhënave të verifikueshme mbi udhëtimet reale të kryera nga subjekti dhe familja e tij, të dhëna të cilat ishin të disponueshme për vitet pasuese.

22. Gjykata vëren, gjithashtu, se analiza financiare e organeve të rivlerësimit, e marrë në tërësi, tregoi një tepriçë të konsiderueshme, konkretisht 1,894,529 lekë për periudhën nga viti 2004 deri në vitin 2009, pra, duke përfshirë vitet para atyre me deficit dhe duke tejkaluar deficitin e përgjithshëm të konstatuar, si dhe një shumë prej më shumë se 4 milionë lekësh për të gjithë periudhën e vlerësimit (shih paragrafët 4 dhe 7 më sipër).

23. Sipas sa më sipër, Gjykata vlerëson, bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të rrethanave specifike të çështjes, se shkarkimi i ankuesit, i justifikuar kryesisht me llogaritje që lidheshin me një vit të vetëm – dhe që duheshin marrë me rezerva – ishte joproporcional me qëllimet legjitime që synonte procesi i rivlerësimit (krahasoni *Sevdari*, cituar më sipër, § 96).

24. Rrjedhimisht, është shkelur neni 8 i Konventës.

ZBATIMI I NENEVE 41 DHE 46 TË KONVENTËS

25. Kërkuesi pretendoi shumën prej 13 600 eurosh (EUR) për dëmin pasuror lidhur me shpenzimet e bëra për gjetjen e një pune të re si avokat pas shkarkimit të tij, por jo për ndonjë pagë të prapambetur apo kompensim tjetër që ai deklaroi se do ta kërkonte para autoriteteve vendase, në përputhje me legjislacionin vendas, në rast të rikthimit të tij në detyrën e prokurorit; 10 000 EUR për dëmin jopasuror; si dhe 9 242 EUR për kostot dhe shpenzimet e kryera para Gjykatës. Kjo shumë e fundit përbëhej nga 7 950 EUR për përfaqësim ligjor, tatimi prej 15% mbi atë shumë dhe 100 EUR për shpenzime administrative.

26. Qeveria i kundërshtoi pretendimet.

27. Gjykata vëren se kërkuesi nuk e provoi dëmin pasuror të pretenduar; prandaj, ajo e rrëzon këtë pretendim. Megjithatë, ajo i akordon kërkuesit 6 000 EUR për dëmin jopasuror, plus çdo tatim që mund të jetë i tarifueshëm.

28. Duke pasur parasysh dokumentet që ka në zotërim, Gjykata e konsideron të arsyeshme të akordojë 5,000 euro për të mbuluar shpenzimet e procedurës para Gjykatës, plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuesit.

29. Kërkuesi, gjithashtu, parashtroi se shteti i paditur duhet të urdhërohet të rihapë procedurat e brendshme dhe, në rast se ai rikthehet në punë, t'i japë atij pagat e prapambetura dhe çdo të drejtë përkatëse.

30. Qeveria nuk u pajtua.

31. Gjykata ka konstatuar një shkelje të nenit 8 sepse shkarkimi i kërkuesit nuk u provua të ishte proporcional me qëllimet legjitime të ndjekura. Në një kontekst të ngjashëm, Gjykata ka treguar se rihapja e procedurave të verifikimit do të ishte e përshtatshme (shih *Sevdari*, cituar më sipër, §§ 144–45, dhe Rezolutën CM/ResDH(2024)212). KPK-ja e ka përfunduar mandatin e saj dhe KPA-ja do ta përfundojë atë gjatë vitit 2026. Neni 179/b § 8 i Kushtetutës së Shqipërisë rregullon trajtimin e procedurave të mbetura pezull ose të pazgjidhura pas përfundimit të këtyre mandateve. Nëse kërkuesi e kërkon këtë, do të ishte e përshtatshme të rihapen procedurat dhe të rishqyrtohet çështja në përputhje me kërkesat e nenit 8, siç përcaktohet në këtë vendim.

PËR KËTO ARSYE, NË MËNYRË UNANIME, GJYKATA:

1. E shpall të pranueshme ankesën për shkarkimin e kërkuesit;

2. Gjykon se është shkelur neni 8 i Konventës;

3. Gjykon:

a) se shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkuesit, brenda tre muajve, shumat e mëposhtme që duhet të konvertohen në monedhën e shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e zgjidhjes:

i. 6000 euro (gjashtë mijë euro) plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme për dëmin jopasuror;

ii. 5000 euro (pesë mijë euro) plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme për kërkuesin, për kostot dhe shpenzimet;

b) se nga përfundimi i periudhës së sipërpërmendur tremujore deri në shlyerje për shumat e mësipërme do të paguhet interes i thjeshtë në normën e barabartë me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mosshlyerjes plus tre pike përqindje;

4. Rrëzon pjesën e mbetur të kërkesës së kërkuesit për shpërblim të drejtë.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 23 qershor 2026, në mbështetje të Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Olga Chernishova
ZËVENDESEKRETARE

Úna Ní Raifeartaigh
KRYETARE